



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 11 Maj 2021

Nr: 81

VENDIM I NDËRMJETËM
PËR SHQYRTIMIN BASHKËRISHT TË KËRKESAVE ANKIMORE NR. 37 DHE NR. 46
DATË 09.05.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 11.05.2021, me pjesëmarrjen e:

Koli BELE	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 37 dhe nr. 46 datë 09.05.2021 të paraqitura në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 132 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenin 19 të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator,

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,



V Ë R E N:

Subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, ka paraqitur pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 37 regj, datë 09.05.2021. Objekti i kësaj kërkesë ankimore është 1- Kundërshtimi i vendimit nr. 340, datë 04.05.2021 të KSHZ-së “Për Miratimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatin e votimit në zonën zgjedhore, qarku Durrës për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputet në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”, 2- Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 25.04.2021; 3- Urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për qarkun Durrës.

Subjekti zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për integrim, ka paraqitur pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 46 regj, datë 09.05.2021. Objekti i kërkesave ankimore janë 1- Kundërshtimi i vendimit nr. 340, datë 04.05.2021 të KSHZ-së “Për Miratimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatin e votimit në zonën zgjedhore, qarku Durrës për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputet në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”, 2- Rinumërim dhe rivlerësim të votave për të gjitha ZAZ e qarkut Durrës.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, në datën 11.05.2021, vendosi të kalonte për shqyrtim dy kërkesat ankimore të paraqitura në KQZ në datën 09.05.2021 dhe datë 10.05.2021. Relatorët e kërkesave ankimore, përkatësisht z. Koli Bele dhe z. Elvis Çefa konstatuan se të dy kërkesat ankimore kanë të njëjtin objekt ankimi: Kundërshtimi i vendimit nr. 340, datë 04.05.2021 të KSHZ-së “Për Miratimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatin e votimit në zonën zgjedhore, qarku Durrës për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputet në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

Në zbatim të nenit 19, pika 1, të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, përcaktohet se, *KAS përpara ose gjatë shqyrtimit të një ankimi administrativ, vendos shqyrtimin bashkërisht të tij me një ose më shumë ankime të tjera, të paraqitura nga subjekte të ndryshme kundër të njëjtit vendim.....*

Përsa më sipër, KAS-i vendos bashkimin e kërkesave ankimore nr. 37, dhe nr. 46 të paraqitura në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të cilat do të shqyrtohen në një seancë. Duke qenë se kërkesa ankimore nr. 37, datë 09.05.2021 është regjistruar më parë në regjistrin e ankimeve se kërkesa ankimore nr. 46, datë 09.05.2021 atëherë të dy kërkesat ankimore do të relatohen nga z. Koli Bele.



PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b” dhe 132 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 19 pika 1, të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, të Komisionit Rregullator

V E N D O S I:

1. Shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 37, datë 09.05.2021, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, dhe nr. 46, datë 09.05.2021, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Durrës.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 12.05.2021, ora 12:00, nga relatori z. Koli Bele.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
4. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

